



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Nëntor, 2024

01-30 Nëntor, 2024

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit nëntor 2023 dhe 2024
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT NËNTOR
2023 DHE 2024**

Gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar **18,118 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1,016.66 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ultë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2023 (19,407 raste ose Inc 1,088.99 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 10,887 raste** ose **610.9/100,000** banorë, **Diarea akute me 4,726 raste** ose **265.19/100,000** banorë, dhe **ARI/ITPR me 1,739 raste ose 97.58** në **100,000** banorë (**Tab.1**).

Gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar 15 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 11 raste me dg. Sepsis me sëmundje përcjellëse, 2 raste me Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse, 1 rast me Lepospirozë dhe 1 rast me Toksoplzmozë

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, NËNTOR 2024

Gjatë muajit nëntor 2024 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit nëntor 2024 në IKShPK janë raportuar 10,887 raste me ILI (Inc. 610.9/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 2.86% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (11,208 raste) por krahasuar me muajin paraprak, tetor 2024 me (9,608 raste të raportuara me ILI) vërehet, rritje prej 13.31%

Diarea akute: Gjatë muajit nëntor 2024 në IKShPK janë raportuar 4,726 raste me Diare akute (Inc.265.19/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (5,728 raste), vërehet një rënie prej 17.5% dhe gjithashtu krahasuar me muajin tetor 2024, me 7,286 raste të raportuara, vërehet rënie prej 35.13%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit nëntor 2024 në IKShPK janë raportuar 1,739 raste me ARI (Inc.97.58/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,382 raste) vërehet një rënie prej 25.83% %, dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak tetor 2024 me (1,490 raste) të raportuara, rënie prej 16.71%.

Variçella: Gjatë muajit nëntor 2024 në IKShPK janë raportuar 519 raste me Variçellë (Inc.29.12/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 me (845 raste) vërehet rënie prej 38.57% e rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak (386 raste), rritje prej 34.45%.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë, 01 – 30 nëntor të vitit 2023 dhe 2024

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë 01 - 30 nëntor të vitit 2023 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	Nëntor, 2023		Nëntor, 2024	
	Nr.	Incidenca / 100,000	Nr.	Incidenca / 100,000
COVID-19	37	2.08	7	0.39
ITPR - Pneumonia/ARI	1382	77.55	1739	97.58
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	3	0.17	24	1.35
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	11208	628.92	10887	610.90
Influenca A		0.00	5	0.28
Influenca B			1	0.06
H.Parainfluenza	1	0.06		0.00
RSV	1	0.06	23	1.29
Rhinovirus	2	0.11		
Diarea acute	5728	321.42	4726	265.19
Variçela	845	47.42	519	29.12
Sindromi meningjeal	18	1.01	7	0.39
EHSV		0.00	1	0.06
Helmimet me ushqim	68	3.82	45	2.53
Infeksionet tjera bakteriale me ushqim		0.00		0.00
Rota virus		0.00		0.00
Salmonella enteritidis	10	0.56	5	0.28
Shigelloza		0.00		0.00
Adenovirus	2	0.11		0.00
Enterovirus				0.00
Gastroenterokolitet	27	1.52	28	1.57
Hepatiti akut B	6	0.34	8	0.45
Hepatiti akut C	1	0.06		0.00
Campylobacter		0.00	1	0.06
Parotiti epidemik	5	0.28	1	0.06
Pertussis	1	0.06	8	0.45
Tularemia	2	0.11	1	0.06
Brucelosis	3	0.17	1	0.06
Leishmaniazë	1	0.06		0.00
WNV		0.00		0.00
Sëmundja Lyme		0.00		0.00
HIV/AIDS	2	0.11	3	0.17
IST	37	2.08	31	1.74
TB			19	1.07
Giardiaza	1	0.06		0.00
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus		0.00	6	0.34
Infeksionet streptokoksike të grupit A			13	
*Sëmundjet tjera ngjitëse	16	0.90	9	0.51
Gjithsej	19407	1088.99	18118	1016.66
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:

Sëmundjet vaksinëpreventabile:

Nga ky grup i sëmundjeve gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar 8 raste të dyshimta me Pertussis (raste të dyshimta dhe të konfirmuara) si dhe 1 rast me Parotit (Tabela 1 dhe 2). Nga gjithsej 19 raste të testuara si raste të dyshimta me Pertussis, nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së janë konfirmuar 8 raste pozitive, prej të cilëve nga 4 rastet e kontaktuara, 3 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë (4 raste), Mitrovicë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat: Suharekë dhe Pejë. Sipas grup-moshës: 0-1 vjeç (1 rast) , 2-4 vjeç (4 raste), 5-9 vjeç (1 rast) 10-15 vjeç (1 rast), dhe 34 vjeç (1 rast) , sipas gjinisë 4 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 4 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Zoonozat dhe sëmundjet transmissive:

Gjatë muajit nëntor 2024, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar: 1 rast me Brucellozë dhe 1 rast me Tularemi. Sipas komunave me Brucellozë (1 rast Podujevë) dhe Tularemi (1 rast Drenas). Të dy rastet i takojnë gjinisë femër dhe grup-moshës (40-49 vjeç). Gjatë kësaj periudhe është raportuar edhe një rast me Ethe Hemorragjike me sindromë veshkore, mashkull me moshë 43 vjeç i cili është nga komuna e Prishtinës ku gjatë periudhës 11.10.2024 deri më 13.10.2024 ka qëndruar dhe prerë drunjë në malet e fshatit Makresh-Artanë.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit nëntor, 2024 në IKSHPK janë raportuar 7 raste me Sindromë Meningjeale (Inc. 0.39/100 000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (18 raste) , vërehet një ulje prej 61%, gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shtator 2024 me (11 raste) të raportuara, vërehet ulje prej 36.3%.

Rastet e konfirmuara sipas komunave: Ferizaj dhe Podujevë me nga 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Prizren. Sa i përket grup- moshës, rezulton se grup- mosha më e prekur është 0-9 vjeç me (3 raste), 60-69 vjeç (2 raste), me nga 1 rast grup moshat 50-59 dhe 70-79 vjeç, kurse grup moshat tjera me asnjë rast të raportuar. Sipas gjinisë, rezulton se gjinia femërore me 57.1% (4 raste) kurse gjinia mashkullore me 42.8% (3 raste). Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, në LCS janë izoluar: 2 raste me HSV1 dhe Human enterovirus, dhe me nga 1 rast Streptococcus pneumoniae, Citomegalovirus, Epstein Barr Virus, HHV6 dhe HHV7.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar 45 raste me Helmim me ushqim, 13 prej tyre të raportuara nga Hani i Elezit si raste të dyshimta të ushqyer në furrën "NN" në Han të Elezit me datë 21.11.2024 Shumica e rasteve janë nxënës të moshës 10-14 vjeç, të cilët kanë konsumuar sandwich me sallamë dhe sos.(shih seksioni epidemitë). Gjithashtu gjatë muajit nëntor 2024 janë raportua edhe 28 raste me Gastroenterokolit

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

4 raste me *Salmonella* Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë: 3 raste Prishtinë dhe 1 rast Skënderaj. Sipas grup moshave 2 raste i takojnë grup moshës 0-9 vjeç, dhe nga 1 rast grup moshës 20-29 vjeç dhe 50-59 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 1 rast gjinisë mashkullore.

2 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë dhe 1 rast Gjakovë. Sipas grup moshave 1 rast i takon grup moshës 0-4 vjeç dhe 1 rast grup moshës 5-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast i takojnë gjinisë femërore dhe 1 rast gjinisë mashkullore.

1 rast me Adenovirus, nga komuna Prishtinës, i takon grup moshës 0-9 vjeç dhe gjinisë femërore.

2 raste me Enterovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Vushtri dhe 1 rast Podujevë, sipas grup moshave 2 rastet i takojnë grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 rastet i takojnë gjinisë femërore.

1 rast me Campylobacter, nga komuna e Pejës, i takon grup moshës 0-9 vjeç dhe gjinisë mashkullore i raportuar nga laboratorit privat "Ndriqimi" në Pejë.

1 rast me Norovirus, nga komuna Prishtinës, i takon grup moshës 0-9 vjeç dhe gjinisë femërore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit nëntor 2024, gjithsej 24 raste SARI u pranuan në spitalet sentinel të Kosovës gjatë mbikëqyrjes epidemiologjike. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV.

Rastet SARI sipas komunave janë Prishtinë (13 raste), Prizren (4 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Mitrovicë (1 rast), Vushtri (1 rast), Gjilan (1 rast) dhe Drenas (1 rast).

Gjatë muajit nëntor, 2024 janë testuar 191 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator. Prej tyre 5 mostra pozitive në Influcencë A (2.65%), 1 moster pozitive në Influcencë B (0.53%), 23 mostra me RSV (12.2%), 20 mostra me Human Rhinovirus (10.63%), 13 mostra me Human Adenovirus (6.91%), 2 mostra me Parainfluenca Virus (1.06%) dhe 1 moster me Metapneumovirus (0.53%).

Rastet pozitive me Influcencë A, sipas komunave : Prishtinë (4 raste) dhe Podujevë (1 rast); Influcencë : Pejë (1 rast); RSV : Prishtinë (14 raste), Podujevë (3 raste), Fushë Kosovë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Ferizaj, Lipjan, Mitrovicë dhe Obiliq. Sipas grupmoshës, me Influcencë A : grupmosha 5-14 (4 raste) dhe grupmosha 35-50 (1 rast); me Influcencë B : grupmosha 5-14 (1 rast); RSV : grupmosha 0-4 (22 raste) dhe grupmosha 5-14 (1 rast).

Prej 5 rasteve me Influcencë A, 4 prej tyre janë të hospitalizuar; Kl. Infektive (2 raste), nga komuna e Prishtinës (1 rast) dhe nga komuna e Podujevës (1 rast); Kl. Pediatrikë (1 rast) nga komuna e Prishtinës dhe Kl. Pulmologjisë (1 rast) nga komuna e Prishtinës. Me Influcencë B: Kl. Pediatrikë (1 rast) nga komuna e Pejës.

Asnjëri nga rastet pozitive me Influcencë A dhe B nuk janë të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 19 raste me TB, të cilat varësisht konfirmimit dhe strategjisë DOTS (terapisë së observuar direkte) do të përditësohen. Gjithashtu nga Infeksionet e grupit A të Streptokokut janë raportuar 13 raste.

Rastet me HIV/AIDS/IST, nëntor 2024

Gjatë muajit nëntor 2024, janë raportuar 3 raste me HIV/AIDS. Dy raste janë me AIDS dhe një me HIV. Rastet i takojnë gjinisë mashkullore, grup moshës 25-34 vjeç dhe janë nga komuna e Prizrenit.

Dy raste rrugën e transmissioinit të infeksioinit e kanë heteroseksuale dhe një rast i takon popullatës kyçe MSM. Dy raste janë nën ARV dhe janë të raportuara nga ana e Kl. Infektive me anë të formës individuale.

Rasti i tretë është dërguar për konfirmim nga ana e laboratorit privat në Prizren për QRSh Prizren dhe pastaj në IKShPK për konfirmim.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht Transmivive (IST), nëntor 2024

Gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar gjithsej 31 raste me Infeksione Seksualisht Transmivise. Rastet e raportuara janë nga komunat: Pejë 14, Ferizaj 8, Prishtinë 4, Lipjan 2, Skenderaj 1, Kaçanik 1 dhe Klinë 1.

Sipas diagnozës: Chlamydia 18 raste, Condyloma 9, Gonorea 3 raste dhe Herpes gjenital 1 rast. Sipas gjinisë: 23 raste (74%) i takojnë gjinisë femërore dhe 8 raste (26%) i takojnë gjinisë mashkullore.

Grup moshë më e atakuar është 25-49 vjeç, 24 raste (77%), 13% (4 raste) i takojnë grup moshës 15-24 vjeç dhe 3 raste (10%) grup moshës mbi 50 vjeç.

Rastet e HIV infeksionit:

- Laboratori referent në IKShPK për HIV e ka kryer konfirmimin laboratorik dhe raportimi i rezultatit është bërë me anë të postës elektronike, përderisa raportimi nga ana e Kl. Infektive është kryer me anë të Formës raportuese me letër dhe janë sjell në dorë.

Rastet e IST-ve të raportuara nga Klinika e Dermatovenerologjise janë përmes fletave (formave raportuese) dhe janë sjell në dorë në Njësinë për HIV/AIDS/IST, ndërsa rastet nga QRSHP Pejë janë raportua përmes postës elektronike.

Asnjë rast i HIV infeksionit apo IST deri me tani nuk është raportuar me SMSN.

Hepatit akut B dhe C

Gjatë muajit nëntor, janë raportuar 8 raste me Hepatit akut B (Mb. 0.44/100.000 banorë). Sipas komunave janë raportuar 3 raste në Mitrovicë, 2 raste në Gjilan dhe me nga 1 rast komunat: Malishevë, Lipjan dhe Podujevë. Sa i përket gjinisë, (5) raste i takojnë gjinisë mashkullore kurse gjinisë femërore 3 raste. Sipas grupmoshës, (3) raste grup moshë 60-69 vjeç, 2 raste grup moshë 20-29 vjeç dhe me nga 1 rast i takojnë grupmoshës 30-39 vjeç, 40-49 vjeç dhe 50-59 vjeç. Gjatë kësaj periudhe, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Hepatit B.

Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, nëntor 2024

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, nëntor 2024																													
SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarrrheac	Variçella	Influenca A	Influenca B	RSV	COVID-19	Sindroma meningjeale			EHSV	Parotitis epidemica	Pertussis	Hepatitac. B	Helminet me ushqim	Gastroenterokolitet	Brucella	Tularimi	Salmonelloza	Infeksi onet virale intestinale dhe ato me	Campylobacter	IST	HIV/AIDS	TB	Infeksi onet streptokoksik të gr. A	Sëm. tjera ngjitëse	Totali
										Meningjiti serosa	Meningjiti purulent	Meningoencephaliti																	
DEÇAN	2		104	61	7																								174
DRAGASH	34		126	76	14																						1		251
DRENAS	59	1	118	49	14				1								1			1							1		245
F. KOSOVË	40	3	556	242	21			2			1					2											2		869
FERIZAJ	21		509	151	6			1			1					1	2							8		6		707	
GJAKOVË	6		151	133	3				6							2	5					1					2		309
GJILAN	35	1	806	308	27									2	1											4		1184	
GRAÇANICË																													0
H. I ELEZIT	24		101	57	1											13													196
ISTOG	4		189	37	2																			1		3			232
JUNIK			42	12																									54
KAÇANIK	11		165	52	10																			1		3		242	
KAMENICË	1		572	135	6																							714	
KLINË	17		122	62	11																			1				213	
KLLOKOT																													0
LEPOSAVIQ																													0
LIPJAN	9		48	46	9			1						1			1								2			117	
MALISHEVË	20		297	174	29									1												1		522	
MAMUSHË																													0
MITROVICË	108	1	495	321	32			1						2	3	1	2				1					1	6	974	
MITROVICË E VERIUT																													0
N. BËRDË			23	11																									34
OBILIQ	36		219	106	23			1										1										386	
PARTESH																													0
PEJË	9		744	296	47			1						1		4	1							1	14			1118	
PODUJEVË	31		930	190	13	1		3			1			1		2	1					1				1		1176	
PRISHTINË	1097	13	3123	1301	111	4		14			1	1	1	4		13	12				3	3		4		1	5706		
PRIZREN	54	4	487	330	35																				3	3	4	921	
RAHOVEC	13		29	36													4	2								1		85	
RANILLUG																													0
SHTËRPCE																													0
SHTIME	15		151	10																									176
SKËNDERAJ	1		119	48	10												1				1			1			1	182	
SUHAREKË	31		349	156	6									1		1										2	1	547	
VITI	8		262	204	18																								492
VUSHTRRI	53	1	50	122	64												1					1						292	
Z. POTOK																													0
ZVEÇAN																													0
PA ADRESË																													0
TOTALI	1739	24	10887	4726	519	5	1	23	7	3	1	3	1	1	8	8	45	28	1	1	5	6	1	31	3	19	13	9	18118

*Sëmudjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza, Adenovirus, Enterovirus

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT NËNTOR 2024

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar dhe rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit nëntor 2024

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	147
SARI	24
COVID-19	1
Hepatitis B	8
Sindroma meningjeale	7
Helmimet me ushqim	23
Diarea akute dhe gastroenterokolite	121
Status febrilis	21
Salmonelloza	2
Mononucleosis	5
Erysipela	6
Vulnus morsum viperi	1
Total	366



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT NËNTOR 2024

Epidemi kolektive e dyshimtë në Helmim me ushqim-Han i Elezit, furra “N.N.”

Epidemia kolektive në Han të Elezit ka filluar më datë 21.11.2024 dhe është zbuluar më 22.11.2024 rreth orës 19:00. Janë raportuar 13 raste të dyshimta të cilët janë ushqyer në furrën “N.N.” në Han të Elezit me datë 21.11.2024 rreth orës 10 e 30. Frekuentimi ditor është 35-40 persona. Shumica e rasteve janë nxënës të moshës 10-14 vjeç, të cilët kanë konsumuar tost me sallamë dhe sos. Simtomet kanë filluar nga ora 01:00 të datës 22.11.2024, ndërsa ndihmë mjekësore në QKMF- Han i Elezit nga ora 07:30-15:00 kanë kërkuar 13 raste. Prej tyre deri me 23.11.2024, një rast është hospitalizuar në Klinikën infektive, 2010, Han i Elezit me Dg. Gastroenterocolitis ac. të gjitha rastet ishin me simptomatologji si: temperaturë, ethe, barkqitje ujore, kokëdhimbje të cilat kanë filluar më datë 22.11.2024 rreth orës 02:00 pas mesnate. Rastet tjera kanë kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF Han i Elezit dhe janë trajtuar në mënyrë ambulatore.

Ekipi nga QRShP Ferizaj në mbështetje të Inspektorit ka vizituar QKMF Hani i Elezit dhe furrën e bukës “N.N.”, vendi ku janë ushqyer rastet e dyshimta të shpërthimit. Janë anketuar 2 raste dhe janë marrë dy mostra për koprokulturë nga rastet të cilët kanë qenë duke u trajtuar në QKMF-Han i Elezit. Në furrën e bukës “N.N.” janë marrë 4 strisho nga mjetet e punës dhe nga personeli.

Mostrat për koprokulturë dhe mostrat e strishove nga hapësirat e punës dhe mjeteve të kuzhinës janë dorëzuar për analizë në Laboratorin e Mikrobiologjisë në QRShP- Ferizaj.

Nga ekipi i QRShP- Ferizaj, është rekomanduar që të raportohen me të dhëna të plota, të gjitha rastet e dyshimta në helmim me ushqim të cilë kanë konsumuar ushqim në furrën në fjalë nga data 21.11.2024. Nga secili rast me simptome: barkqitje, vjellje, dhimbje barku etj. të kërkohet marrja e mostrave të fecesit për koprokulturë dhe janë dhënë rekomandime për praktikatat e mira higjieno-sanitare punëtorëve që punojnë në furrën e bukës” NN”.

Nga QRShP-Ferizaj informohemi se nga inspektori nuk është rekomanduar marrja e mostrave të ushqimit si dhe mbyllja e furrës. Nga 4 mostra të marra për kontrollë steriliteti -3 rezultojnë negative ndërsa mostra e marrë nga duartë e punëtores në furrë ka prezencë të staflokokut saprofit. Nga 6 mostra të marra për koprokulturë të gjitha kanë rezultuar negative në baktere patogjene. Mostra e ujit e marrë në objektin e furrës ka rezultuar brenda parametrave standard të ujit të pijes.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 30 komuna ose 78.9% (30/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

6. COVID-19

Gjatë muajit nëntor 2024, janë testuar 484 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe prej tyre 7 raste pozitive me SARS-CoV-2 janë raportuar në IKShPK me shkallë të pozitivitetit 1.44%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 (37 raste pozitive të raportuara), vërehet një ulje prej 81% e rasteve të raportuara. Gjatë muajit nëntor 2024 nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19. (Grafikoni 1).

Sipas komunave, numri më i lartë i rasteve pozitive është nga komuna e Gjakovës me 6 raste të raportuara dhe Drenasit me 1 rast. Sipas Incidencës: Gjakova me 6.3/100,000 dhe Drenasi me 1.7/100,000 banorë.


Sipas grup-moshës, numri i rasteve pozitive me COVID-19 janë si vijon: Grup-mosha 60-69 vjeç me 3 raste si dhe me nga 1 rast grup-moshat: 0-9, 30-39, 70-79 dhe 80+ Sipas Incidencës specifike, dominon grup-mosha 80+ me 2.91/100,000 banorë dhe 60-69 vjeç me 2.15/100,000 banorë. Sa i përket numrit të rasteve pozitive, sipas gjinisë kemi 5 raste (71%) të gjinisë femërore dhe 2 raste (29%) të gjinisë mashkullore

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detektive) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detektive).

Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3.

Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të të gjitha shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara, të shëruara dhe vdekjet nga COVID-19, nëntor 2024



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, NËNTOR 2024

Sëmundja e panjohur në Republikën Demokratike të Kongos

Midis 24 tetorit dhe 5 dhjetorit 2024, zona shëndetësore Panzi në Provincën Kwango të Republikës Demokratike të Kongos regjistroi 406 raste të një sëmundjeje të panjohur me simptome: ethe, dhimbje koke, kollë, rrjedhje hundësh dhe dhimbje trupi me 31 raste të vdekjes (CFR prej 7.6%).

Shpërthimi është ende në vazhdim. Sipas një konference për shtyp nga Ministria e Shëndetësisë më 5 dhjetor, janë raportuar disa vdekje shtesë jashtë objekteve shëndetësore (vdekje në komunitet). Këto vdekje duhet ende të hetohen, të karakterizohen (mosha, gjinia etj) dhe të verifikohen. Të gjitha rastet e rënda u raportuan se ishin të keqshqyer rëndë. Në zonën shëndetësore Panzi, fëmijët e moshës 0-14 vjeç përfaqësojnë 64.3% të të gjitha rasteve të raportuara, me grupmoshat 0-59 muaj (53%), 5-9 vjeç (7.4%) dhe 10-14 vjeç (3.9%) të rasteve. Femrat përbëjnë 59,9% të totalit të rasteve. Ndër vdekjet, 71% janë nën moshën 15 vjeç, me 54,8% të totalit tek fëmijët nën moshën pesë vjeç.

Zona e prekur është zonë rurale dhe e largët, me akses të penguar më tej nga sezoni i vazhdueshëm i shirave. Arritja në të nga Kinshasa me rrugë kërkon rreth 48 orë. Këto sfida, së bashku me diagnostikimin e kufizuar në rajon, kanë vonuar identifikimin e shkakut themelor.

Ekipet e reagimit të shpejtë janë vendosur për të identifikuar shkakun e shpërthimit dhe për të siguruar reagimin. Ekipet janë duke mbledhur mostra për testime laboratorike, duke ofruar një karakterizim klinik më të detajuar të rasteve të zbuluara, duke hetuar dinamikën e transmetimit dhe duke kërkuar në mënyrë aktive për raste shtesë, si brenda objekteve shëndetësore ashtu edhe në nivel komuniteti.

Ekipet e reagimit po ndihmojnë gjithashtu në trajtimin e pacientëve, komunikimin e rrezikut dhe angazhimin e komunitetit. Duke pasur parasysh paraqitjen klinike dhe simptomat e raportuara, si dhe një numër vdekjesh shoqëruese, pneumonia akute, gripit, COVID-19, fruthi dhe malaria po konsiderohen si faktorë të mundshëm, me keqshqyerjen si një faktor kontribues. Malaria është një sëmundje e zakonshme në këtë zonë dhe mund të jetë shkaktar ose kontributdhënës në rastet. Testet laboratorike janë duke u zhvilluar për të përcaktuar shkakun.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, niveli i përgjithshëm i rrezikut për komunitetet e prekura vlerësohet si i lartë.

Në nivel kombëtar, rreziku konsiderohet i moderuar për shkak të natyrës së lokalizuar të shpërthimit brenda zonës shëndetësore Panzi në provincën Kwango. Megjithatë, potenciali për përhapje në zonat fqinje, së bashku me boshllëqet në sistemet e mbikëqyrjes dhe reagimit, nënvizon nevojën për gatishmëri të shtuar.

Në nivel rajonal dhe global, rreziku mbetet i ulët në këtë moment. Megjithatë, afërsia e zonës së prekur me kufirin me Angolën ngre shqetësime për transmetimin e mundshëm ndërkufitar dhe monitorimi i vazhdueshëm dhe koordinimi ndërkufitar do të jenë thelbësore për të zbutur këtë rrezik.

Detektimi i virusit vaksinal Tip 2 të Polios në Rajonin Evropian, rëndësia e vaksinimit dhe rritjes së vigjilencës

Në tri vende të Rajonit Evropian të OBSH-së (Gjermani, Poloni dhe Spanjë) që nga shtatori i këtij viti përmes mbikëqyrjes rutinë të sistemeve të ujërave të zeza është detektuar qarkullimi i virusit vaksinal Tip 2 të Polios. Asnjë rast human nuk është zbuluar deri më sot, por prania e virusit nënvizon rëndësinë e vaksinimit dhe mbikëqyrjes, si dhe rrezikun e vazhdueshëm që çdo formë e poliovirusit paraqet për të gjitha vendet kudo.

Rajoni ka qenë i lirë nga poliomieliti endemik (polio) që nga viti 2002. Megjithatë, për sa kohë që çdo formë e poliovirusit po përhapet kudo në botë, ai mund të importohet. Importime të tilla mund të çojnë në shpërthime nëse virusi gjen rrugën e tij tek individët e pavaksinuar, siç ndodhi në Taxhikistan dhe Ukrainë në 2021, dhe Izrael dhe Mbretërinë e Bashkuar në 2022.

Të gjitha vendet në rajon janë në gatishmëri për importe të rasteve të tilla dhe shumë prej tyre bëjnë mbikëqyrjen rutinë të sistemeve të ujërave të zeza për të siguruar zbulimin e hershëm. Nivelet e vazhdueshme të larta të vaksinimit janë jetike për të parandaluar që virusi të rivendosë një bazë në çdo komunitet.

Në 3 muajt e fundit, virusi vaksinal polio i tipit 2 (VDPV2) u detektua në mostrat e ujërave të zeza në Barcelonë, Spanjë; Varshavë, Poloni; dhe Këln, Bon, Hamburg dhe Mynih, Gjermani. Virus i detektuar është i lidhur gjenetikisht me një lloj që u shfaq në Nigeri. Ky lloj qarkullon në disa vende jashtë rajonit, më gjerësisht në Afrikën Veriore dhe Perëndimore.

Në të 3 vendet e Rajonit Evropian, virusi u izolua vetëm nga mostrat mjedisore (të ujërave të zeza) – nuk është zbuluar asnjë rast paralitik i poliomielitit.

“OBSh vazhdon të mbështesë autoritetet kombëtare dhe lokale të shëndetit publik në hulumtime dhe monitorimin e situatës duke përfshirë identifikimin e çdo boshllëku të mundshëm.

Gjermania, Polonia dhe Spanja bëjnë mbikëqyrje të zgjeruar të sëmundjeve dhe kanë shkallë të larta të mbulimit rutinë me imunizim, të vlerësuar në 85-93% në nivel kombëtar me 3 doza të vaksinës së poliomielitit të inaktivuar (IPV), e cila siguron mbrojtje të shkëlqyer nga paraliza e shkaktuar nga poliovirusi. Megjithatë, xhepat vaksinal ekzistojnë në çdo vend. Në përgjigje të zbulimeve, hulumtimet janë në vazhdim, duke përfshirë mbikëqyrjen e vazhdueshme të sëmundjes.

Sëmundjet zoonotike në rritje në BE: rastet e Listeriozës kanë arritur nivelin më të lartë që nga viti 2007

Numri i rasteve humane të raportuara të listeriozës (2,952) tregoi një rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2019-2023, duke arritur nivelet më të larta që nga viti 2007. Kjo mund të lidhet me plakjen e popullsisë së Evropës - 21.3% e evropianëve tani janë mbi 65 vjeç - e cila, në lidhje me përhapjen në rritje të sëmundjeve kronike të lidhura me moshën, rrit rrezikun e simptomave të rënda në grupmoshat më të mëdha. Ushqimet e kontaminuara të gatshme për t'u ngrënë (RTE), të tilla si salmoni i tymosur i ftohtë, produktet e mishit dhe produktet e qumështit, janë burimi më i zakonshëm i infeksioneve. Të dhënat më të fundit tregojnë se përqindja e mostrave nga kategoritë ushqimore RTE që tejkalojnë kufijtë e kontaminimit të sigurisë ushqimore për *Listeria monocytogenes* varionte nga 0.11% në 0.78%, me nivelin më të lartë të raportuar për salcice të fermentuara.

Kampilobakterioza dhe salmoneloza ishin sëmundjet zoonotike më të shpeshta të raportuara te njerëzit në BE. Në vitin 2023, u raportuan 148 181 raste të kampilobakteriozës, duke shënuar një rritje nga 139,225 në 2022.

Pas kampilobakteriozës, salmoneloza ishte infeksioni i dytë gastrointestinal më i raportuar te njerëzit, me 77 486 raste, krahasuar me 65 478 raste në vitin 2022. Vetëm 15 Shtete Anëtare dhe Mbretëria e Bashkuar (Irlanda e Veriut) përmbushën me sukses të gjitha objektivat e vendosura për reduktimin e Salmonellës në shpendët. Kjo paraqet një rënie në krahasim me vitin 2022, kur 19 Shtete Anëtare arritën pajtueshmërinë e plotë.

8. REKOMANDIMET

Në funksion të pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në Kosovë, sëmundjet ngjitëse duhet të raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës në kohë reale, në mënyrë që informata kthyesë dhe përgjigja epidemiologjike të jetë me kohë.

Të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse, bazuar në ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200.

Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit dhe paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse si në Institucionet shëndetësore publike dhe private.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë bashkëpunimin ndërsektorial dhe themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**

